

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Frymëmarrje" shpk**

Sot, më datë 23/05/2024, u paraqit personalisht:

- **Zj. Kristina Gjini**, e datëlindjes 25/03/1995, shtetase shqiptare, lindur ne Lezhe dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e leternjoftimit me Nr. 038829471 dhe Nr. Personal J55325034E.

e cila përpiloi këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare "**Frymëmarrje**" sh.p.k, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "**Frymëmarrje**" sh.p.k, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "**Frymëmarrje**" sh.p.k, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**

**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "**Frymëmarrje**" sh.p.k dhe me emrin tregtar **Frymëmarrje**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Prodhimi, tregtimi me shumice dhe pakice i konstruksioneve murale dekorative me gjelberim natyral. Projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative me bimesi natyrale per ambientet e brendshme dhe te jashtme. Realizimi i paterneve te ndryshme me fokus lulet natyrale. Ndertim i fasadave me gjelberim natyral.

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiraneë, në adresën: **Njesia Administrative Nr. 11, Don Bosko, Ndertesa. 18, Hyrja 5, Tiranë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.



## NENI 6

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortakët themelues:

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: Lekë 100.000 (njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

## NENI 7

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare " Frymëmarrje " sh.p.k zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	<b>Kristina Gjini</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesëmarrja në Shoqëri :	<b>100,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>100,000 ( njqind mije) leke</b>

Duke qenë se Kapitali themeltar do të depozitohet në llogarinë e Shoqërisë e cila do të hapet pas regjistrimit në QKB, atëherë ortakët vendos që kjo shume do të paguhet prej tij jo më vonë 3 muaj nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, në llogarinë e shoqërisë tregtare. Rregullat e pagesës së kësaj shume janë parashikuar në këtë Statut.

## NENI 8

### Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 9

### Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë :

- **Zj. Kristina Gjini**, e datëlindjes 25/03/1995, shtetase shqiptare, lindur në Lezhë dhe banues në Tiranë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtese e letërnjoftimit me Nr. 038829471 dhe Nr. Personal J55325034E.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes te gjuhes shqipe.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Kristina Gjini**

